



Nr. 3819 / Prot
2

Fier më, 31/03 /2026

PROCESVERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 31.03.2026. Sot në sallën e mbledhjeve ora 13:30. Të pranishëm në mbledhje 34 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përshëndetje të nderuar këshilltarë! Fillojmë mbledhjen e radhës. Me porosi të Kryetarit të Bashkisë është thirrur mbledhja e radhës, në bazë të nenit 53 të Ligjit 139/2015. Rendin e ditës ju ka ardhë me rrugë elektronike të gjithë këshilltarëve, jeni njohur me këtë rend dite. Por dua t'ju bëj me dije se nga ana e administratës së Bashkisë dhe Kryetarit, në lidhje me pikën 8 të rendit të ditës, nuk është projekt-vendim por thjesht është një relacion, një informacion në lidhje me dhënien me qira të pasurisë tregut të frutave-perimeve, dykaçe, në lagjen Kastrioti. Nuk ka vendimmarrje në lidhje me këtë, po thjesht është një informacion. Dhe përveç 15 projekt-vendimeve të parashikuara në këtë njoftim për zhvillimin e rendit të ditës, shtohen edhe dy projekt-vendime të cilat ju kanë ardhur. Është Plani Social i Bashkisë, i cili ju është njoftuar dhe njëkohësisht është dhe vijimi i procedurave të privatizimit të banesave nga administrata e Bashkisë. Fillimisht, përpara se të fillojmë mbledhjen, hedhim në votim rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:


1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 27.02.2026.
3. Projekt - vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % për muajin Shkurt 2026."

1

4. Projekt - vendim: "Për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave (PBA) 2027-2029."
5. Projekt - vendim: "Për miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm 2027-2029" të Bashkisë Fier
6. Projekt - vendim: "Për shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Fier për Vitin 2026"*
7. Projekt - vendim: "Për dhënien e miratimit për nxjerrjen nga inventari të aktiveve, pasurisë të llojit 'ndërtes' (Ilogaria ekonomike 212) të Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit. Bashkia Fier"
8. Projekt - vendim: "Për miratimin e vijimit të procedurës për dhënie me qira të pasurisë nr. S/89 zk. 8534 me sipërfaqje totale 1584 m² (tregu i frula - perimeve, ndërtesë dy - katëshe) lagja Kastriot" Fier, në pronësi të Bashkisë Fier".
9. Projekt - vendim: "Për miratimin e kërkesës së shoqërisë 'Poëer Energy' sh.p.k. për dhënie të drejtës së kalimit 'Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore të transmetimit të energjisë elektrike' në pronat e Bashkisë Fier"
10. Projekt - vendim: "Miratimin e Planit të masave për mbrojtjen kundër zjarrit' dhe Planit të Veprimit' për Bashkinë Fier. për vitin 2026.
11. Projekt - vendim: "Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjimore në 2026-2028. Bashkia Fier.
12. Projekt - vendim: Për miratimin e pagesës për mbulimin e shpenzimeve të transportit motor për të ndjerin Detlef Ferig. në vlerën prej 20,000 lekish.
13. Projekt - vendim: "Për miratimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Qirjako Ferti në vlerën prej 84,000 lekësh.
14. Projekt - vendim: "Për një ndryshim në VKB Nr. 14, datë 29.01.2026. *Për ngritjen e komisionit për trajtimin e kërkesave për ndihmë të menjëhershme dhe për riparim banesash' pranë Bashkisë Fier."
15. Projekt - vendim: "Për dhënie të titullit Qytetar Nderi z. Miti Nushi dhe z. Lllazar Pove."

16. Diskutime dhe komente.

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.



2

Projekt-vendim: Për miratimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale 2026-2028 të Bashkisë Fier

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

Projektvendim: “ Mbi miratimin e vijimit të procedurave administrative-ligjore nga Komisioni i privatizimit , Bashkia Fier , për familjen e shtetasit Agim Balil Skëndaj , për të cilin është miratuar nga Këshilli i Bashkisë Fier datë 11/12/2025, Relacioni Nr.13941 Prot, datë 16/11/2025 “ Mbi shqyrtimin e kërkesës për kryerjen e procedurës së privatizimit të shtetasit Agim Balil Skëndaj “ në mbledhjen e Këshillit të bashkisë Fier datë 11/12/2025 .

Z.Marjus Voja

Kryetare, pa u miratuar rendi i ditës, kam një propozim, që pikën për “Dhënien e titullit Qytetar Nderi” ta shtyjme për mbledhjen e ardhshme, për shkak se nuk kemi informacion të detajuar dhe nuk kemi marrë një vendim për dhënien e titullit.

Z.Agron Profka

Më fal kryetare, se kjo punë u bë shty e shty. Informacioni është marrë, është plotësisht i marrë informacioni.Nuk e kuptoj se për çfarë arsye shtyhet.Nuk po e kuptoj këtë. Për të marrë një certifikatë, një copë kartoni dy veta, është bërë një problem. Është turp se s’po dalim dot në qytet e Fierit, është turp.

Znj.Antoneta Çunaj

Unë jam I mendimit që këtë konflikt ta zgjidhim mbrapa. Në votim hedhim njëherë këto që jemi dakord të tërë. Pikat e rendit të ditës I hedhim në votim, përveç pikës 15 të rendit të ditës...

Z.Marjus Voja

Do ta hedhim në votim edhe pikën 15 për ta përjashtuar nga rendi i ditë.

Znj.Antoneta Çunaj

Po dale një minutë, se s’mund të hidhet ashtu sepse tani po bëhet kërkesa.

Z.Marjus Voja

Në rregull.

Z.Ilia Fili

Mund të bëj një sygjërim për rendin e ditës, të lutem kryetare?

Znj.Antoneta Çunaj

Po për kë?

3

Z.Ilia Fili

Për rendin e ditës.

Znj.Antoneta Çunaj

Po

Z.Ilia Fili

Dalë nga dalë ne po bëjmë tre vjetë që jemi në këtë sallë, dhe kam konstatuar që në pikën e fundit që janë “Diskutime dhe shtrim problemesh nga anëtarët e këshillit”, çdo gjë që aty thuhet, grupi i madh ngrihet në këmbë dhe ikën dhe smerret vesh as se ç’farë sygjerojnë anëtarët e këshillit. Ne s’kemi detyrë vetëm të miratojmë materialet që na vijnë nga Bashkia, po kemi detyrë të sjellim zërin e qytetarit këtu. Po këtu në këtë pikë mbyllet mbledhja ngrihen në këmbë të tërë pikërisht në pikën e fundit.Do të sugjeroja që kjo pika e fundit të kalojë pika e parë për tu miratuar “Diskutime dhe sjellje problemesh nga anëtarët e këshillit”. Sepse tre vjet është kjo procedurë kështu, që nuk dëgjohet. Anëtarët e këshillit sjellin problem, nuk dëgjojnë. Unë këtë sugjeroj.

Z.Kreshnik Dapi

Tani, me leje? Kam edhe unë një...

Znj.Antoneta Çunaj

Po, po.

Z.Kreshnik Dapi

Si anëtar I kryesisë, me kolegun Ilia Fili preku një pikë shumë të ndjeshme dhe ajo që qëndron... dua të bëj një thirrje dhe ne e kemi marrë si vendim në mbledhjen e fundit të kryesisë. Mbledhja e sotme po zhvillohet përsëri, për të shumtën herë, në kufijtë e paligjshmërisë . Të dal te ajo që tha kolegu Ilia Pini. Rregullorja e këshillit bashkiak është një format i rendit të ditës, të cilën ne nuk e kemi zbatuar asnjëherë. E citove në fillim të mbledhjes se mbledhjen e ka thirrur Kryetari I Bashkisë. Nuk është e vërtetë. Mbledhja është e rradhës. Në bazë të nenit që cituat, Kryetari i Bashkisë thërret mbledhje jashtë rradhe, ka të drejtë. Bile, me thënë të drejtën, këtë mbledhje...

Znj.Antoneta Çunaj

Jo, jo, nuk është ashtu...mbledhjen e thërret Kryetari i Bashkisë, projekt- vendimet i bën administrata e bashkisë. Po patët edhe ju, 1/3 e këshilltarëve me shkrim , thërret mbledhjen dhe bën një projekt-vendim.



Z.Kreshnik Dapi

Më lini ta mbaroj mendimin që mos ta hamë kohën kotë.

Znj.Antoneta Çunaj

Po

Z.Kreshnik Dapi

Sot jemi me 5 ditë vones nga rregullorja që kemi votuar të gjithë bashkë ' e enjtja e fundit të çdo muaji` dhe ta shpjegoj dhe këtë. I dhamë kohë administratës sepse në mënyrë skandaloze na vijnë nga drejtuesit e administratës justifikime që s`kemi kohë, nuk kemi mundësi, dhe I gjithë dokumentacioni, që në fakt nuk mungon ky dokumentacion, nuk është ligjor dhe administrativ për këtë mbledhje të radhës të këshillit bashkiak. Po bëjmë thirrje që në muajin prill, kryesia do të zhvillojë mbledhjen e radhës në datën 20, të jetë e përcaktuar korrekt rregullores së këshillit bashkiak, dhe që në datën 20 çdo material I juaji duhet të kalojë nga zyra e protokollit të Bashkisë në drejtim të sekretarit të këshillit bashkiak. Ne nuk do të vendosim asnjë pikë në rendin e ditës pa qenë e sigluar rregullisht, në origjinal dhe e protokolluar në protokollin e Bashkisë. Dhe nga mbledhja e prillit, do bëjmë dhe vërejtjen e kolegut Ilia Fili, do operojmë me një format të ri të rendit të ditës ku mund ta shikoni shumë qartësisht nga ju në rregulloren e këshillit bashkiak që ka 30 minuta diskutime dhe kërkesa nga këshilltarët, para se të fillojmë me pikat e shqyrtimit të projekt-vendimeve. Kaq kisha, faleminderit.

Znj.Antoneta Çunaj

Tani më falni, sepse nga administrata është hequr dhe pika 12 e rendit të ditës që ka të bëjë me një projekt-vendim për dhënien e një pagese të një transporti të një të vdekuri, pasi nuk është dokumentacioni I plotë ligjor.

Z.Kreshnik Dapi

Jo vetëm nuk është, po dokumentacioni për turp... kemi dy raste për ata të dy të ndjerë, me shumë respekt I kujtoj, dhe kemi dy raste për dhënien e ndihmës ekonomike dhe siç po thosha më lart, mirë ne e mirëkuptojmë drejtorinë e financës për tavanet buxhetore dhe planin afatmesëm që nuk ka mundësi dhe janë voluminoze. Tani, të kërkosh fonde për shpenzime mortore për dy të ndjerë dhe mos të bijesh as projekt-vendimin, as relacionin që s`është I sigluar në protokoll, as dokumentin e identifikimit të të ndjerit, as faturën e pretenduar nga kompania...

5

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk është miratuar, po çfarë diskuton?

Z.Kreshnik Dapi

Jo, po diskutoj që të keni kujdes se është fyerje.

Znj.Antoneta Çunaj

Ne po themi po e heqim nga rendi I ditës. Dakord? Tani mos e diskuto më sepse po them që edhe pika 12 e rendit të ditës...

Z.Endri Jaupaj

Kryetare jepja fjalën ekzekutivit që të japi pretendimet e veta nqs ka diçka për të thënë.

Znj.Antoneta Çunaj

Iku, se do ta heqin. Tani nuk ka pse të diskutohet një projekt-vendim që tërhiqet nga Bashkia.

Z.Endri Jaupaj

Ti e kalon në votim rendin e ditës, ndërkohë që rendi i ditës, ne po e themi sepse në cilësinë e anëtarit të kryesisë vjen pa u plotësuar në formën ligjore që do të duhej të ishte.

Znj.Antoneta Çunaj

Këto janë shpenzime emergjente. Tani nuk ka të bëjë me materiale sepse nuk është... po është komplekse materiali... materiali duhet të vijë dhe nga policia për shtetasin e huaj...

Z.Endri Jaupaj

Dhe prandaj ti i drejtohesh këshillit dhe i thua: e kalojmë pikën e rendit të ditës.Drejtoju administratës sepse ke një administratë prej 470 punonjësish që nuk plotësojnë dot materialet për një muaj kohë, ndërkohë që ekzekutivi i bashkisë nuk bën asnjë punë dhe një kryetar bashkie që bledh këshillin dhe nuk vjen vetë, është hera e katërt që nuk merr pjesë.

Znj.Antoneta Çunaj

Është e drejtë e tij. Po e ke kërkuar ndonjëherë ti?

Z.Endri Jaupaj

Do ti referohesh ligjit se është e drejtë e tij po jo pa fund. Nqs ai ka hequr dorë nga mandati i tij , të iki dhe të shikojë hallin.

Znj.Antoneta Çunaj

Tani e hedhim në votim, përveç atyre pikave të rendit të ditës, është relacioni, pika 12 hiqet, përveç pikës 15 do ta hedhim në votim të veçantë. Kush është dakord me rendin e ditës?

6

Z.Ilia Fili

Më fal, unë bëra një sugjerim. Hidheni, shtroja sallës sugjerimin që bëra unë. Nqs salla e kundërshton...

Znj.Antoneta Çunaj

Çfarë ishte?

Z.Endri Jaupaj

Ta ka thënë, pse nuk e kupton? Diskutimet dhe problematikat që vijnë këtu, pra zëri i qytetarit të dëgjohet, këtë po thotë inxhinieri. Tek diskutimet çohesh ti dhe ikën e para.

Znj.Antoneta Çunaj

Pro 33 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

Të nderuar këshilltarë . Kur votohet kini mendjen, ngrini kartonat. Ndryshe mosngritja e kartonit do të lexohet si votë pro. ose dilni nga salla në qoftë se nuk dëshironi të votoni.

Z.Endri Jaupaj

Jo, si dal nga salla?

Znj.Antoneta Çunaj

Jo, në qoftë se nuk dëshironi të votoni, thashë.

Z.Endri Jaupaj

Si, si se nuk të dëgjova?

Znj.Antoneta Çunaj

Endri dëgjo, mos fol kur flas unë.

Z.Endri Jaupaj

Mbaroje.

Znj.Antoneta Çunaj

Mbarova

Z.Endri Jaupaj

Nuk të kuptova.Ma thuaj dhe njëherë si ishte?

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk e kuptove dëgjoje.



7



Z.Armando Çupaj

Kryetare, të lutem votoje edhe njëherë sepse nuk u panë votat abstenim.

Znj.Antoneta Çunaj

Një abstenim ishte.

Z.Endri Jaupaj

Ka të drejtë sekretari, do ti përmendësh të gjitha votat.

Znj.Antoneta Çunaj

Ngrini kartonat lart.

Pro 31 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim 2 vota.

Miratohet.

Z.Endri Jaupaj

E ndreuar kryetare. Sa vota ke pro?

Z.Armando Çupaj

Prezent në sallë janë 34 këshilltarë në këtë moment.

Z.Endri Jaupaj

Duhet t'i numërosh, e ke gabim.

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk i numëroj, numëroi ti nqs do.

Z.Ilia Fili

Tani kam për të bërë një sugjerim, një propozim. Këtë propozim unë kam të drejtë tua shtroj ju dhe ju t'ja jepni sallës. Jeni dakord që pikën e fundit të ngrejmë në krye të rendit të ditës? Hidhe në votë.S:janë dakort u mbyll muhabeti.Po hidhe në votë.

Znj.Antoneta Çunaj

Po dale ta miratojmë rendin e ditës. Një minutë, një minutë, ta hedhim në rend dite, për arsye se përfaqësuesi i Partisë Socialiste, këtë gjë e vërtetoi që kishte mendimin që pika 15 të rendit të ditës... po mirë mo dale, ne po themi ta miratojmë njëherë, pastaj e çojmë te pika 1 apo 2. Ta miratojmë njëherë, do bëhet sot apo jo kjo pika 15?

8

Znj.Edlira Durmishaj

Kryetare,po flasim thjesht për pikën “Diskutime nga anëtarët e këshillit”, pra ato që ne sjellim nga qytetarët, diskutimet që vijnë gjatë muajit.A po flisje për këtë inxhinier apo jo?

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk mund të lihen diskutimet në fillim. Tani, në lidhje me propozimin e inxhinierit, të gjitha këto... thashë se si bëhen propozimet, bëhen me 1/3 e këshilltarëve me shkrim nëse do të ndryshosh rend dite, ose ke në kryesi përfaqësuesin tënd, atje diskutoja, nuk bëhen sot këto gjëra këtu me një individ. Nuk e lejon ligji, konkretisht neni 53 I ligjit 139/2015. Prandaj, tani jini të vëmendshëm...

Z.Ilia Fili

Shumë mirë që po e zbatoni ligjin zonja kryetare.Mmë vjen mirë shumë që e keni kuptuar dhe e keni zbatuar gjithë kohën. Po unë jam anëtar I këshillit bashkiak , jam jashtë kryesisë, e kam të drejtë, në mbledhjen e këshillit të shtrojë problemet.Unë nuk ngre probleme pa vlerë . ngre probleme me shumë vlerë sepse ky këshill për tre vjet nuk është dëgjuar fare se çfarë sjellim ne nga jashtë këtu. Vepron vetëm një mekanizëm, pro, kundra, abstenim.

Znj.Antoneta Çunaj

Po, e thashë, e kemi vënë. Nuk ta kam mohuar, Tani, atë bëje me rregull, bëje me shkrim, bëje... po kështu e ka ligji,

Z.Ilia Fili

Ok, e kuptova.

Znj.Antoneta Çunaj

Tani në lidhje me pikën 15 të rendit të ditës. Kush është pro të shqyrtohet sot neni 15, I titujve të nderit të dy qytetarëve të nderuar? Kush është pro që të futet ky në rend dite? Kush është pro?

Z.Endri Jaupaj

O kryetare, diskutoje njëherë me kryetaren e komisionit sepse pretendimet janë për të qënë më shumë se sa dy qytetarë.

Znj.Evis Sema

Kryetare a mund të bëj një sqarim?Mos i vërë këshilltarët jashtë atyre mundësive që ndodhen.
Të lutem!

Z.Endri Jaupaj

O kryetare, do t'ia japësh fjalën kryetarëve të grupit se tani nuk kemi rregull...

Znj.Antoneta Çunaj

Dale një minutë, Visa të lutem. Tani, kryetari i grupit kërkoi që të hiqet nga rendi I ditës. Tani, a do ta... tani ka të drejtë, prandaj votohet në fillim rendi I ditës, që anëtarët e këshillit kanë të drejtë që nga rendi I ditës të heqin ndonjë pikë të rendit të ditës siç ka dhe administrata. Dhe kanë të drejtë se prandaj votohet rendi I ditës.

Znj.Evis Sema

Mos të diskutohet fare kjo sepse nuk po e sqaron.

Znj.Antoneta Çunaj

Mos të diskutohet këtë radhë , po të lihet në mbledhjen e ardhshme.

Z.Endri Jaupaj

O kryetare do ta zbatojmë rregulloren mos tua japësh fjalën kujdo nga anëtarët e këshillit përpara kryetarëve të grupeve?

Znj.Antoneta Çunaj

Po ti pse merr fjalën? Pse merr fjalën? Ti pse merr fjalën?

Z.Fndri Jaupaj

Në dijeninë time personi në fjalë nuk është kryetar grupi. Të mbarojnë kryetarët e grupeve pastaj jepua fjalën këshilltarëve të tjerë.

Znj.Antoneta Çunaj

Një minutë. Po jo, edhe ti s'ke të drejtë fjale. Kur ta jap fjalën! Po nuk është për kryetar grupi , sepse është rend dite, nuk ka filluar. Nuk jemi te rendi I ditës. Jo, edhe ti s'mund ta marrësh fjalën, nuk lejohet. Tani, kur t'ju japim fjalën...

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë në emër të grupit Social Demokrat, propozoj dhe dua mbështetjen e gjithë kolegëve këtu në këshill, që pikën në fjalë, pikën 15 .ta kalojmë, sepse normalisht kemi të bëjmë me dy figura të shquara, kanë shkëlqyer, i meritojnë titujt "Qytetar Nderi", por duke qenë se pamë edhe vërejtjet në mbledhjen e kaluar, gjatë kësaj periudhe patëm dhe ankesa nga disa familjarë se për hirë të së vërtetë. këta dy zotërinj kanë shkëlqyer në atë fushë, kanë qenë pjesë e një grupi që quhej "Kënga Qytetare Fierake" dhe nuk kanë qenë si solistë, kanë qenë së bashku

10

me pesë kolegë të tjerë themelues, disa prej të cilëve fatkeqësisht nuk jetojnë më. Dhe unë propozoj si kryetar grupi që ne atë listë me dy zotërinjtë në fjalë ta mbështesim, ta votojmë, por të shtojmë edhe pesë emrat e tjerë, duke qenë se gjithçka mbi të cilën ne progresojmë, ata është krijuar me kontributin e ndërthurur dhe të përbashkët të të shtatë këngëtarëve. Konkretisht janë...

Znj. Antoneta Çunaj

Tani, po jemi jashtë rendit të ditës

Z. Kreshnik Dapi

Kam dy minuta më lërë ta mbarojë fjalën.

Znj. Antoneta Çunaj

Jo, e para njëherë që ky material me dy emra ka ardhur shoqëruar me dokumentacion. Këta që thoni ju, pa dokumentacion...

Z. Kreshnik Dapi

Jo, jo nuk ka ardhur me dokumentacion por ka ardhur me propozim.

Znj. Antoneta Çunaj

Me propozim, po kanë edhe dokumentacion. Tani doni ti votoni këtë radhë apo doni që ta shtyjmë për radhën tjetër? Po apo jo?

Z. Kreshnik Dapi

Ne duam ti votojmë këta të dy por duke shtuar edhe pesë të tjerët.

Z. Marjus Voja

O kryetare, unë ju thashë ta shtyjmë për mbledhjen tjetër.

Znj. Antoneta Çunaj

Po hedh në votim propozimin e kryetarit të grupit të PS-së.

Z. Agron Proka

Kryetare të lutem shumë, unë kam mendimin. T'i kalojmë këta të dy sipas propozimit që ka ardhur nga Shoqata Kulturore Artistike e Greqisë, t'i kalojmë këta të dy dhe radhën tjetër, në qoftë se ka propozime të tjera për grup e për të tëra, le të vijnë kërkesat e ta votojmë.

Znj. Antoneta Çunaj

Jo ashtu, jo

Znj. Yllka Sheshi

Unë nuk e kuptoj dot sepse që kur kemi bërë mbledhjen e komisionit kanë qenë dhe përfaqësues që mendoj se duhet të jenë pjesë e këtij grupi, dhe dëgjuam propozimin tonë për të bërë një shtesë veç këtyre dy emrave që vërtet e meritojnë. Dhe brenda komplet kohës së duhur, ata nuk denjuan të sillnin të paktën emrin e Jani Tasit. Po edhe të tjerët që e meritojnë gjithsesi. Tani, unë nuk e kuptoj dot, a marrim rrogë këta individë që janë të përcaktuar, se vërtet zonja... kush ishte ajo shoqata... shoqata që ishte nga Greqia që i kishte propozuar këta dy individë. Po tani, meqë ky grup nuk ka qenë prej dy anëtarësh, po ka qenë më shumë, pse nuk i sollën në komisionin ose në mbledhjen e ardhshme që është sot?

Znj.Antoneta Çunaj

Po i sjellim, po i marrim, bëjeni me projekt- vendime.! Po i sillni me dokumentacionin përkatës dhe hajdeni ti miratojmë.

Znj.Yllka Sheshi

Unë si individ, flas si individ, jam ndjerë shumë keq sepse...

Znj.Antoneta Çunaj

Po tani për çfarë për rendin e ditës po të vjen keq ty?

Znj.Yllka Sheshi

Po këta dy individë le t'i votojmë dhe të detyrohen ata që janë, që duhet të plotësojnë dokumentacionin për grupin.

Znj.Antoneta Çunaj

Do e hedh në votim? Dakord. Tani, do hedh në votim pikën 15 të rendit të ditës siç është. Kush është dakord?

Z.Marjus Voja

Dakort për çfarë ?

Znj.Antoneta Çunaj

Për pikën 15 të rendit të ditës siç është.Për ta shqyrtuar sot sepse kur u votua për miratim rendi i ditës kjo pikë u la të votohej më vete.

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë ka dy propozime. I pari të të votohet për pikën 15 siç është paraqitur pika në rendin e ditës dhe i dyti, ai që bëri grupi jonë për ti shtuar edhe 5 emrat e tjerë të grupit të "Këngës Qytetare Fierake.

Znj.Antoneta Çunaj

Tani një minutë. Fillimisht si rregull, hidhet propozimi që është në rendin e ditës, dhe në qoftë se bie ai, automatikisht është i rënë.

Z.Kreshnik Dapi

Neve pikën e kemi në rendin e ditës.

Znj.Antoneta Çunaj

Po nuk e kemi miratuar sepse e përjashtuam kur votuam rendi i ditës.

Z.Marjus Voja

Hidhe në votim për ta hequr nga rendi i ditës.

Znj.Antoneta Çunaj

Hajde pra, dakord. Kush është pro për ta hequr nga rendi i ditës pikën 15 të rendit të ditës?

Pro 26 vota.

Kundra 5 vota.

Abstenim 3 vota.

Miratohet.

Pika 15 e rendit të ditës hiqet nga rendi i ditës dhe do të kalojë për shqyrtim në mbledhjen tjetër.Po.

Z.Ilia Fili

Unë ju falenderoj juve për vendimin që morët, po më vjen keq që kjo sallë është kthyer në një sallë politike dhe nuk vlerësuat dy artistët e Fierit. Vajti ky problem deri në asamblenë e partisë socialiste. Unë s'e konsideroj dot, s'e kuptoj dot çfarë është kjo verbëri ndaj artistëve Fierak. Sinqerisht po ju them.Unë nuk ju njoh por zhurma është e jashtëzakonshme që po bëni dhe këtu nuk është problemi i vlerësimit, se janë apo sjanë artistë, po janë probleme thjesht personale që shtrihen në ngjyrë politike pastaj. Po kaq kisha zonja kryetare. Dhe për mua, për mua është një turp që kjo bashki dhe ky këshill mori këtë.

Z.Marjus Voja

Kjo nuk ka asnjë prapavijë politike.Ne nuk jemi kundra që të marrin tituj qytetarët fierak por duam të marrim një informacion nqs janë dy apo pjesë e grupit janë edhe të tjerë, ti verifikojmë dhe nuk jemi kundra për të dhënë titullin qytetarë nderi.

Pika e parë e rendit të ditës.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është dakort për miratimin e rendit të ditës me ndryshimet që thamë?

Pro 34 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 27.02.2026.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është dakord me procesverbalin e mbledhjes? Ju është dhënë përfaqësuesve të partive politike, është nënshkruar dhe është konform rregullave. Jeni njohur dhe ju nëpërmjet këtij dokumenti të sjellë nga sekretaria. Kush është dakord me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së këshillit të datës 27?

Pro 33 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % për muajin Shkurt 2026."

Znj.Antoneta Çunaj

Materiali ju ka ardhur. Fillimisht e kanë fjalën kryetarët e grupeve të komisionit, pastandaj kryetarët e grupeve të forcave politike dhe më pas këshilltarët. Po, keni... është mbledhur komisioni përkatës? Po.

Z.Elvi Daka

Përshëndetje të gjithëve. Në fakt, është mbledhur komisioni përkatës ditën e djeshme. Në këtë rend dite kemi vetëm një familje të re që hyn në skemën e ndihmës ekonomike 6% dhe numri total i familjeve është 47 për Bashkinë Fier. Kështu që kjo është një procedurë e përmuajshme që ky këshill merr vendim. I ftoj të gjithë kolegët ta miratojmë futjen e kësaj familjeje, kryefamiljare...

Znj.Antoneta Çunaj

Ju keni dalë me vendimmarrje?

Z.Elvi Daka

Patjetër. Jemi një nga bashkitë që ka numrin më të ulët në skemën e ndihmës, kështu që patjetër.

Znj.Antoneta Çunaj

Po. Kryetarët e grupeve do fjalë? Ka njeri fjalë? Këshilltarët? Jo. Hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave (PBA) 2027-2029."

Znj.Antoneta Çunaj

Ky materiali ju ka ardhur. Fillimisht nëse komisioni është mbledhur në lidhje me këtë projekt-vendim?

Znj.Erlinda Llupi

Po, komisioni është mbledhur ditën e djeshme dhe ka vendosur ta kalojë për miratim në këshill.

Znj.Antoneta Çunaj

Po. Kryetarët e grupeve duan fjalë? Këshilltarët? Po, po.

Z.Kreshnik Dapi

Të nderuar kolegë, pas shqyrtimit të vëmendshëm të projekt- raportit për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029, mund të them që kemi përpara një dokument që ndonëse shfaq ambicie në rritje të ardhurash, fsheh dhe disa asimetri ose mospërputhje dhe defekte strukturore që rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të Bashkisë Fier. Më poshtë kemi paraqitur pikat ku ky raport çalon dhe ku duhet të ketë një farë llogaridhënie.

E para është skandali, po që se e keni vënë re në dokumenta, i taksës së fjetjes ose që mund ta quajmë dhe dështimin e kontrollit mbi turizmin. Raporti aty pranon me një gjuhë teknike, por që është alarmante, se të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel për vitin 2025 janë parashikuar vetëm 42.000 lekë të reja. Kjo shifër është qesharake për një qytet si qyteti jonë, çka tregon se hotelet e qytetit dhe zonat bregdetare pothuajse deklarojnë zero tatim fjetjeje, ndërkohë që

shfrytëzojnë infrastrukturën tonë, të qytetit. Dhe raporti nuk propozon asnjë masë ndëshkuese apo plan inspektimi në terren, por mjaftohet me konstatimin e evazionit në fjalë. Ky mund të quhet një dorëzim i administratës tatimore para biznesit, i cili abuzon.

Pika e dytë që më shqetëson është barra e pabarabartë midis familjeve dhe biznesit. Në raport thuhet se 94% e taksapaguesve janë familjarë dhe vetëm 6% janë biznes. Këtu ekziston një rrezik i lartë që rritja e të ardhurave të planifikuara për 2027-2029 të bjerë mbi kurrizin e qytetarëve të thjeshtë. Nga analiza e riskut që unë bëj, nënkuptohet që në kohën kur 12% e familjeve trajtohen me lehtësi sociale, pjesa tjetër e shtresës së mesme po mb ngarkohet. Dhe raporti nuk specifikon se si do zgjerohet baza e biznesit, por vetëm se si do shtrydhen ato databaza ekzistuese të individëve.

E treta është problemi i bujqësisë, ose në thonjëza "detyrimi i bujqësisë", që për mendimin tim nënkupton një rritje artificiale. Raporti krenohet me rritjen e vlerës së taksës mbi tokën bujqësore, duke lidhur këtë me faktin se fermerët janë të detyruar të paguajnë për të përfituar naftë falas ose subvencione të tjera. Ky nuk është ose nuk mund të quhet si sukses i administratës së kësaj bashkie, por një efekt anësor që vjen nga politikat kombëtare. Rreziku është se në momentin që skemat e subvencionit mund të ndryshojnë apo të ulen, të ardhurat e bashkisë nga bujqësia do të pësojnë kolaps, pasi nuk ka një kulturë vullnetare të pagesës së kësaj takse, por kryhet gjithmonë një pagesë nën kushtëzim ose sforcim.

Pika e katërt është si gjithmonë dhe e famshmjia varësia nga transfertat e pakufizuar nga pushteti qendror. Dhe për periudhën 2027-2029, Bashkia Fier mbetet nën infuzion nga qeveria qendrore. Rritja vjetore prej 5% e transfertës që shkon në rreth 948 milionë lekë të reja, tregon se ne nuk jemi ende një bashki që vetë-mjaftohet ose autonome. Dokumenti nuk paraqet asnjë plan tjetër se çfarë mund të ndodhë nëse rritja ekonomike kombëtare ngadalësohet dhe transfertat nuk rritet sipas parashikimit të Ministrisë së Financave. Ne po planifikojmë shpenzime mbi para që në të vërtet nuk i kemi ne në dorë.

E pesta është dobësia, siç cilësohet aty, në përditësimin e kadastrës ose hipotekës. Raporti pohon se taksa e ndërtesës do të bazohet në vlerën e tregut, por pranon se ka vonesa në përditësimin e databazave nga kadastra, hipoteka. Kjo të bën të dyshosh se parashikimet e të ardhurave për vitet 2027-2029 janë bërë mbi shifra teorike. Nëse kadastra nuk dorëzon regjistrin e plotë të pasurive, atëherë plani ynë buxhetor do të mbetet thjesht një listë dëshirash dhe parashikimesh në letër.

Rekomandimet më të sakta, ose rekomandimet e mia, tona, do të ishin në këshill: E para, auditimi i menjëhershëm i sektorit të turizmit. Nuk mund të ecim duke miratuar PBA-të, ku hotelet paguajnë gjithsej sa fatura e ujit të një familjeje. Ndërkohë kërkojmë dhe një plan operativ të taksës së fjetjes. E dyta, rishikimi i barrës mbi biznesin e madh, të rritet eficientia e mbledhjes të ky 6-përqindëshi i biznesit, për të lehtësuar presionin mbi 94-përqindëshin e familjeve. Dhe transparencën si gjithmonë të mirë-administrimit, e cila duket si fjalë boshe, por që ne duhet të dimë me saktësi sa është kostoja reale e mbledhjes së këtyre taksave. Të nderuar kolegë, raporti ka nevojë për korrigjime të thella para se të kthehet në një hartë ose në një detyrim financiar për qytetarët e Fierit. Unë nuk mund të votoj një parashikim që bazohet në fat ose në detyrime të tjerëve, por një formë e cila është konkrete dhe e garantuar. Faleminderit.

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit! Tani, nga përfaqësuesit e grupeve të tjera ka nevojë kush të flasë? Anëtarë këshilli? Pyetje ka ndonjëri në lidhje me materialin? Sepse prandaj e kemi administratën këtu. Ka ndonjëri? Jo. Nuk ka. E hedhim në votim. Kush është pro?

Z. Endri Jaupaj

O kryetare, një sekondë se nuk ka folur ekzekutivi për këtë projekt-vendim.

Znj. Antoneta Çunaj

Çfarë do të flasi? Po ju them, a keni pyetje?

Z. Endri Jaupaj

Minimalisht të marrë fjalën ekzekutivi. Po hyre në debat minimalisht gjysmë ore diskutim vetëm nga ekzekutivi.

Znj. Antoneta Çunaj

Po jo more jo! Ke pyetje? Bëj pyetje. Ke pyetje? Pro? Kush është pro?

Znj. Antoneta Çunaj

Po të them... ekzekutivi do futet nqs keni pyetje ju. Keni pyetje? Pyetje keni? Ore pyetje, sqarime, interpretime, ke? Çfarë do ti që të flasë? Ja ty po ta jap fjalën, Endri. Bëj pyetje! Bëj pyetje, bëj pyetje.

Z.Endri Jaupaj

Që ta kuptosh, ti po hedh në votim ndërkohë që ekzekutivi nuk ka folur akoma.

Znj.Antoneta Çunaj

Po sepse ti e ke materialin përpara.

Z.Endri Jaupaj

Jepja fjalën ekzekutivit të flasë për këtë projekt-vendim, kryetare!

Znj.Antoneta Çunaj

Tani, kush është pro?

Pro 32 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

Pika e pestë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm 2027-2029" të Bashkisë Fier

Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni për këtë pikë të rendit të ditës?

Znj.Erilda Llupi

Komisioni vendosi ta kalojë për miratim.

Znj.Antoneta Çunaj

Tani, kryetarët e grupeve duan fjalën? Ti e ke Endri, fol. Meqë do të flasësh. Pyetje, përgjigje, sqarime, interpretime.

Z.Endri Jaupaj

Merre njëherë ti fjalën o kryetare.

Znj.Antoneta Çunaj

Jo, jo, merre ti. E ke ti. Do ta marrësh fjalën apo jo? Ndonjë anëtar këshilli do ta marrë fjalën? Po, vazhdo.

Z.Melsi Bogdani

Një pyetje kam unë, zonja kryetare.): Ekzekutivi... çfarë funksioni ka në mbledhjen e këshillit se nuk po e kuptoj? Ngriti kolegu një sërë shqetësime dhe nuk mori asnjë lloj përgjigjeje. Tani ekzekutivi është këtu për të parë se si do debatojmë unë me ty këtu, apo është për të marrë ne përgjigje që të kthjellohemi mbi relacionet përkatëse ?

Znj.Antoneta Çunaj

Po, po të thashë. Sepse ai foli në formë diskutimi. Unë ju pyeta: "Ka ndonjëri pyetje?". Unë po e hap përsëri diskutimin. Tani meqë...

Z.Melsi Bogdani

Kolegu diskutoi 5 minuta dhe ngriti një sërë shqetësimesh Mbi ato që ngriti kolegu... nuk ka asnjë nga ekzekutivi që të japë një përgjigje?

Znj.Antoneta Çunaj

Këroheni të drejtën. Kërkoni fjalën dhe të tërë janë të gatshëm si nga ekzekutivi, drejtorët, dhe nënkryetarët janë të gatshëm të japin sqarimet. Kërkoni të nderuar këshilltarë sqarime. Detyrimin administrata e ka për tu përgjigjur vetëm kur e kërkoni ju.

Z.Endri Jaupaj

Ke projekt-buxhetin afatmesëm, po flasim për dy vite, po flasim për menaxhimin e qytetit. Po flasim sepse është pika më e rëndësishme. Ekzekutivi do ta marrë fjalën vetë. Merr, flet ekzekutiv, dëgjojmë ne të tjerët.

Znj.Antoneta Çunaj

Po qe i qartë ti nuk ka nevojë që të flasi ekzekutivi.

Z.Nustret Avdullai

Sa për një sqarim. Në mbledhjet e kaluara të Këshillit Bashkiak, e kam ngritur këtë pretendim. Po është kështu si thoni ju. Ekzekutivi duhet të referojë, pastaj fillon procedura. Radhën e parë na u hodhët në grykë që kjo sallë është e jona, ju s' duhet të flisni. Unë u interesova për rregulloren dhe rregullorja është kështu siç thoni ju Z.Jaupaj, ekzekutivi paraqet projekt-vendimin, amendamentin e kështu me radhë, ju bëni pyetjet e duhura, kthehen përgjigjet e kështu me radhë. Radhën e parë kur doli ky problem, juve na thatë kjo sallë është e jona, madje dhe me një llojë arrogance, nuk po flas me emra as për vete as për ju, por po them në përgjithësi këshilli. Normalisht kështu duhet të jetë dhe unë mendojë që kështu duhet të jetë, dhe rregullorja kështu e ka të përcaktuar, ekzekutivi paraqet projektvendimin, vijnë pyetjet nga komisionet ku është shqyrtuar, këshilltarët e veçantë bëjnë pyetjet e duhura dhe ekzekutivi përgjigjet. Kjo është rrjedha normale e këshillit. Falemenderit!

Znj.Antoneta Çunaj

Vazhdo Pranvera.

Znj.Pranvera Cina

Faleminderit kryetare. Atëherë, këshillit I është paraqitur raporti i vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave afatmesëm për vitin 2027-2029 dhe nuk jemi në fazën e programit të buxhetit afatmesëm. Jemi në parashikimin e të ardhurave afatmesëm. Për sa i takon taksës së fjetjes në hotel, është e vërtetë që realizimi ka qenë i ulët, por ne e kemi parashikuar këtë taksë duke u bazuar në analizën që kemi bërë, mbi rritjen e një strukture që do të funksionojë për mbledhjen e kësaj takse. Dhe është shpjeguar dhe në relacion.

Z.Endri Jaupaj

Sa ka qenë vitin e kaluar?

Znj.Pranvera Cina

E keni... e keni aty. Faktin e vitit 2025 e kemi 42 mijë lekë, ndërkohë planifikimi...

20

U përgjigj të tëra pyetjeve apo atyre paqartësive të tua? Pastaj do ta jap ty fjalën? Po.

Z.Kreshnik Dapi

Duke debatuar do të marrim kohë sepse Pranvera e di që ky është një debat teknik. Unë e falenderoj Pranverën për përgjigjen, pavarësisht përmbajtjes, kam... nqs unë vazhdoj, do të marrë kohë shumë sepse duhet ta kuptojnë të gjithë këtu që ky është një debat teknik, që në rradhë të parë ka të bëjë me vizionin se si drejtohet ky institucion. Prandaj dhe Pranvera, unë e vlerësoj, është specialiste shumë e mirë, por nuk është personi adapt për t'i dhënë përgjigje se nuk është ajo që vendos. Pranverës unë i lë një porosi, siç e thashë si anëtarë kryesie, të bien dokumentat ligjërish, administrativisht, OK, që do të thotë të firmosura, të vulosura, të protokolluara, që quhen dokumenta zyrtarë. Dokumentat që citon këtu kryetarja e këshillit janë dokumenta që mund të përdoren për informim, por nuk janë dokumenta për vendimmarrje. Nuk mund të na dërgoni një file në Word ne, që është lehtësisht i manipulueshëm dhe nuk e dimë ku është prodhuar, ku është protokolluar. E kuptoni? Të vijmë këtu të marrim vendimmarrje kaq të mëdhaja? Gabimi ka qenë i të gjithë neve, dhe i imi i pari që flas kështu që e kam pranuar dhe kam vazhduar këtë tre vjet me këtë ecuri. Sepse te ky raport me buxhetin që kemi cilësuar që erdhi se do dalë në një temë që ka lidhje edhe me këtë, që vjen ajo e famshmja 15% investime kapitale dhe realizimi faktik 27-28% dhe është dorëzuar në kohë. Që do të thotë në realitet, ne pas kemi shpenzuar, investuar gati 30% të 15-përqindëshit. Ose 5%, 4%. Prandaj, që të vish këtu në këshill dhe të kërkosh këto gjëra, e para duhet të vijë e gjithë databazën nga ke dalë ti me këtë dokument Word që ne na nis. Nuk dua as të të...më fal, me gjithë respektin, dhe ty dhe Elenit, as t'ju ofendoj as t'ju bëj të ndiheni keq, po në qoftë se doni të flasim, flitet kështu drejt. Në qoftë se doni të bëjmë gjasme e ngremë kartonin siç e kemi ngritur, dhe vazhdojmë.

Znj.Pranvera Cina

Dhashë një shpjegim në lidhje me ato çfarë parashtruat.

Z.Kreshnik Dapi

Neve na bini këto dosjet e plota sidomos tek projektvendimet e rëndësishme.

Znj.Pranvera Cina

Materiali ju ka ardhur elektronikisht.

22

Z.Kreshnik Dapi

Nuk është materiali ai që na dërgon në Word. Aty ka edhe gabime por unë nuk t'i thashë. Kaq kisha unë .Faleminderit !

Znj.Pranvera Cina

Planifikimi i të ardhurave afatmesëm është dhe në sistemin e planifikimit buxhetor vendor që menaxhohet nga Ministria e Financave.

Z.Nustret Avdullai

Në lidhje me materialin që ju vijnë... nuk është e nevojshme të kalojnë tek zyra e protokollit.

Z.Kreshnik Dapi

Jo, jo, është taksative në rregullore. Për ne, jo për ju thashë.

Z.Nustret Avdullai

Atëherë, vjen materiali këtu, juve në këtë material mund të keni sugjerimet tuaja. Dhe mund të votoni ndonjë sugjerim të tuajin...tip amendimi

Z.Kreshnik Dapi

Jo, jo Nustret e ke gabim.

Z.Nustret Avdullai

Prandaj po them që këtu vjen materiali, ju për çdo pikë... mund të keni pretendimet tuaja, mund ta votoni ose ta rrëzoni sipas dëshirës suaj.

Z.Kreshnik Dapi

Me leje kryetare, mund ta sqaroj. Ne dy përfaqësuesit, zoti Arbjon Behari dhe zonja Eleni Gjikonaj... i sqaruam në mbledhjen e kryesisë. Është mirë që kush nga ju është caktuar të bashkëpunojë me këshillin bashkiak të njohë rregulloren e këshillit bashkiak. Ne operojmë mbi atë rregullore. Rregullorja thotë të prerë, të qartë, taksative, çdo projekt-akt, çdo rezolutë, çdo propozim, çdo çdo dokument që kërkon vendimmarrje në këshill, duhet të dorëzohet nga propozuesi, dërguesi, apo kush do tjetër, në protokollin e bashkisë. Dhe protokollin, sipas ligjeve



23

të tij, ka disa specifitime që do të thotë që do materialin origjinal, të sigluar, të vulosur etj. Dhe këto nuk janë bërë kot, janë bërë qëllimisht që materiali të ketë formë juridike, zyrtare të plotë dhe përgjegjësi, të gjitha llojet e përgjegjësive, qoftë penale, qoftë administrative.

Mbi materialet që na vijnë ne, të marrësh vendimmarrje tani, me miliarda lekë dhe të thuash “haide se po e bëjmë” se është e lodhur zonja e financës, apo zotëria, apo ky këshilltari Kreshnik , është i lodhur nuk e di ta lexojë ashtu, është budallëk në gjuhën popullore. Ne duam nga muaji prill çdo material në zyrën e protokollit. Unë i pari si anëtar kryesie nuk firmos më asnjë material, asnjë vendim për mbledhjen e këshillit.

Znj.Antoneta Çunaj

Faleminderit! E do ndonjë tjetër nga anëtarët e këshillit fjalën?

Z.Endri Jaupaj

Meqë jemi tek funksioni i financave, kanë ardhur disa kërkesa që janë drejtuar Kryesisë për ndihma të menjëhershme por që kanë kaluar nga zyra e financës. Meqë kemi përfaqësues këtu të ekzekutivit, a mund të thonë çfarë i ka penguar që t'i sillnin materialet për shqyrtim në Këshillin Bashkiak dhe ne të vendosim ti kalojmë apo jo?

Znj.Antoneta Çunaj

Ne kemi kërkuar për ti kaluar në komision.

Z.Endri Jaupaj

Komisioni nuk është ngritur dhe ata njerëz që kanë bërë kërkesat nuk mund të presin derisa të ngrihet komisioni sepse komisioni mund të mos ngrihet kurrë.

Znj.Antoneta Çunaj

Jo, jo e ke në rendin e ditës sot plotësimin e këtij komisioni.

Z.Endri Jaupaj

Nuk ka lidhje komisioni. Kanë ardhur kërkesat për ndihmë të menjëhershme. A i kanë marrë në shqyrtim? A i kanë shqyrtuar?

Znj.Antoneta Çunaj

24

Jo nuk i kanë marrë në shqyrtim sepse ramë dakort si këshill që ne do të ngremë një komision të posaçëm për të përcaktuar kriteret se kush do të përfitojë nga ata që kanë bërë kërkesa dhe pasi të shqyrtohen nga komisioni do të vijnë në këshill dhe të miratohen. Kush është dakord me pikën pesë të rendit të ditës?

Pro 30 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim 3 vota.

Miratohet.

Z.Kreshnik Dapi

Kryetare nuk jemi Live, kanë hequr fishën.

Znj.Antoneta Çunaj

Po unë nuk mbaj fishën. Ju të tëra mi kërkonin mua, të drejtoj mbledhjen të mbaj fishën. Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projektvendimn: "Për shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Bashkisë Fier për Vitin 2026"

Znj.Antoneta Çunaj

Komisioni përgjegjës është mbledhur në lidhje me këtë fakt?

Znj.Erlinda Llupi

Po është mbledhur dhe ka vendosur ta kalojë për miratim në këshill.

Znj.Antoneta Çunaj

Nga kryetarët e grupeve do ndonjëri fjalën? Jo. Nga anëtarët e këshillit do ndonjëri fjalën? Ndonjë sqarim nga administrata keni? Jo. E miratojmë, e hedhim për miratim.

Z.Endri Jaupaj

Një sekondë! Edhe këtu prapë me shkelje të rregullores sepse duhet të flasi prapë ekzekutivi.

Znj.Antoneta Çunaj

Po nuk duan ore.Doni ju të flisni?

Z.Niko Neço

Të nderuar këshilltarë, të nderuar të pranishëm. Në vijim të relacionit që kemi vënë në dispozicion në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, është paraqitur nga ekzekutivi propozimi për shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Fier deri në datën 30 qershor 2026. Ky propozim, siç është parashtruar edhe në relacion... Ky material është bazuar në disa konsiderata të marra dhe disa elementë të parashtruar në relacion, dhe ajo që është më kryesorja ka të bëjë me detyrimet që ka Bashkia Fier për zhvillimin ekonomik lokal dhe mbështetjen e biznesit lokal dhe subjekteve të tatimpaguesve. Nxitja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, duke shmangur krijimin e detyrimeve prapambetura dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet administratës vendore dhe komunitetit të biznesit. Dhe gjithashtu, ajo që është kryesore për t'u theksuar, të nderuar, është se kjo nismë apo ky propozim nuk përmban falje të detyrimeve, por është vetëm shtyrje e afatit të përmbushjes me qëllim lehtësimin e përkohshëm të barrës financiare të tatimpaguesve ekonomikë në territorin e Bashkisë Fier.

Znj.Antoneta Çunaj

Keni pyetje, sqarim, interpretime nga administrata? Doni ndonjë gjë? Jo. Hidhet në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet

Pika e shtatë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për dhënien e miratimit për nxjerrjen nga inventari të aktiveve, pasurisë të llojit 'ndërtes' (Ilogaria ekonomike 212) të Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit. Bashkia Fier"



Znj. Antoneta Çunaj

E keni lexuar materialin? Ju ka ardhur. Komisioni përkatës e ka parë dhe çfarë ka vendosur?

Znj. Erlinda Llupi

E kemi diskutuar në komision, jemi me dy vota kundër dhe tri vota pro për ta kaluar në këshill.

Znj. Antoneta Çunaj

Tani kush e do fjalën? Po.

Z. Kreshnik Dapi

Siç e tha kolegja Erlinda, unë jam një nga votat kundër në komision. Materialet edhe për këtë pikë kaq të rëndësishme nuk kanë ardhur dhe për hirë të së vërtetës nuk kemi asnjë material. Siç e thamë edhe te të tjerat, projektvendimi, relacioni janë në një format Ëord të paligjshëm. Tani mgjth, mbi atë informacion që na është dhënë, ashtu si na është dhënë, tani ashtu do flasim. Kemi këtë projektvendim për nxjerrjen nga inventari të pasurisë ndërtesë që është nën administrimin e Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit. Po të shikosh në një analizë të relacionit shoqërues që kemi dhe dokumentit mbështetës, duket qartë që ky material jo vetëm që është i pasaktë në formë, por paraqet mangësi serioze edhe në procedurë që mund të cenojë edhe integritetin e kësaj vendimmarrjeje. Tani, kush janë konstatimet? Konstatimet sipas këtyre që shohim në material janë katër pika kritike që kërkojnë dhe këto një përgjigje para se ne të ngremë dorën. Pika e parë: aty në relacion, si gjithmonë, kemi pasaktësi kronologjike dhe dokumentare. Kemi në relacion të cituar një shkresë me numrin 2582 të protokollit, e cila është me dy data të ndryshme: 25 shkurt 2026 dhe 25 shkurt 2025. Tani kjo mund të jetë thjesht lapsus, por në gjykimin tim kjo është një pakujdesi administrative që tregon si mungesë serioziteti në hartimin e një akti të rëndësishëm i cili po tjetërson një pronë publike. Si mund të votojmë në një vendim ku administrata nuk është e qartë nëse kërkesa është bërë para një muaji apo para një viti? Pika e dytë është dhe duket qartë mungesa në zinxhirin e administrimit. Dokumentacioni vërteton se në vitin 2016, me urdhër të kryetarit të Bashkisë numër 202, kjo pasuri ka kaluar në inventarin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Sot kërkesa për nxjerrje nga inventari na vjen nga Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit. Në materialin që kemi në dispozicion nuk ekziston asnjë akt ligjor apo dokument që provon se si dhe kur kjo pasuri ka kaluar nga Shërbimet Publike te Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit. Tani ne nuk



mund të nxjerrim nga inventari i një ndërmarrjeje një pasuri që ligjërisht nuk figuron e regjistruar në emrin e saj. Pika e tretë është ajo që unë mund ta quaja "aset fantazmë", e thashë dhe në mbledhjen e komisionit. Sepse sipas relacionit, procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit të ri, të quajtur Stacioni i Zjarrfikësve, mban datën 7 mars 2025. Pra prej më shumë se një viti godina e vjetër të paktën nuk ekziston më fizikisht. Por ne mund të mendojmë që ajo ka edhe më tepër se një vit që nuk ekziston më në gjendjen e saj fizike. Sepse mbi të pastaj, në 7 mars, është marrë në dorëzim dhe vërtetuar që është ngritur një investim i ri. Pse kjo procedurë vjen sot? Një vit e më shumë me vonesë. Për më tepër kur akti i demolimit që duhet të shoqërojë nxjerrjen e një ndërtese nga inventari mungon. Pa këtë akt demolimi, ne thjesht po legalizojmë në letër një situatë që duhet të ishte audituar me kohë. Nëse është bërë, duhet të kishim një raport nga auditimi. Pika e katërt është ajo që vjen pas kësaj: llogaritja fiktive e amortizimit. Relacioni llogarit amortizim të aktit deri në 31 dhjetor 2023. Megjithatë, leja e ndërtimit për stacionin e ri është dhënë në gusht të 2023-it. Është e qartë se si llogaritet amortizimi i një godine që në atë periudhë duhet të ishte shembur ose jashtë funksionit për shkak të punimeve. Kjo tregon një mungesë analize reale ekonomike dhe një kalim mekanik shifrash nga një vit në tjetrin. Atëherë, në gjykimin tim propozoj që ky material t'i kthehet administratës për saktësim të datës së protokollit për të qënë formalisht korrekt dhe zyrtarisht, paraqitjen e aktit që mungon në dokumentacion të kalimit të pronës nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit dhe paraqitjen e procesverbalit të shembjes së godinës së vjetër. Deri në atë moment vota ime dhe e kolegëve të mi do të jetë abstenim.

Znj. Antoneta Çunaj

Tani kush e ka përgatitur këtë material? Çfarë dëgjoi në lidhje me faktin nga administrata? Kush e ka përgatit materialin?

Z. Endri Jaupaj

Të mos kalojë në votim në qoftë se s'është ai që ka përgatit materialin. E thotë rregullorja.

Znj. Pranvera Cina

Është një grup pune që ka përgatitur këtë material.

ka përgatit materialin?

28



Z.Endri Jaupaj

Përfaqësuesi i grupit të punës .

Znj.Pranvera Cina

Mund të flas unë për pjesën që i takon financës?

Znj.Antoneta Çunaj

Po vazhdo mqs je pjesë e grupit të punës.

Znj.Pranvera Cina

Në lidhje me këkesën ku citohen dy datat 26 shkurt 2026 dhe 26 shkurt 2025: është një gabim i thjeshtë date, data e saktë është 26 shkurt 2026.

Z.Kreshnik Dapi

Prandaj dokumentat nuk nisen në Ëord.

Znj.Pranvera Cina

Dokumentacioni ju niset në rrugë elektronike për çështje shpejtësie dhe lehtësie për ju.

Z.Kreshnik Dapi

Në rrugë elektronike për tu lavdëruar është vetëm Nasip Bani, drejtori i emergjencave Civile i cili i dërgon konform ligjit, asnjë tjetër nga ju.

Znj.Pranvera Cina

Dokumentacioni fizik është i administruar pranë zyrës së protokollit dhe është i plotësuar nga gjithë dokumentacioni justifikues që është relatuar nga Drejtoria e Financës. Atëherë ne jemi për nxjerrjen nga inventari të vlerës kontabël, flasim në këto momente, për të mos vazhduar për të qëndruar në dokumentacionin financiar të Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit. Në vitin 2016 është bërë transferimi i asetëve nëpërmjet një VKM-je, ka qenë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, i ka kaluar Bashkisë Fier, Ndërmarrja e Shërbimeve Rurale saktësisht, i ka kaluar Bashkisë Fier dhe me urdhër është bërë aset i Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit.

Znj.Antoneta Çunaj

Do ndonjëri fjalën tjetër nga anëtarët e këshillit?

Z.Kreshnik Dapi

Kryetare, s'ka nevojë ta vazhdojmë me pikën tjetër, s'ka asnjë dokument, asnjë gjë. Është humbje kohe! Unë e bëra fjalën dhe një sërë sugjerimesh...

Znj.Pranvera Cina

Dokumentacioni është i gjithi, i ke të protokolluara.

Z.Kreshnik Dapi

I ke ti aty, duhet ti kishim ne këtu.

Znj.Antoneta Çunaj

Tani ky projektvendim do të hidhet në votim. Kush është dakord me këtë projektvendim?

Pro 29 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim 5 vota.

Miratohet

Pika e tetë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për miratimin e vijimit të procedurës për dhënie me qira të pasurisë nr. 5/89 zk. 8534 me sipërfaqje totale 1584 m² (tregu i frula - perimeve, ndërtesë dy - katëshe) lagja Kastriot" Fier, në pronësi të Bashkisë Fier".

Znj.Antoneta Çunaj

Pika tetë e rendit të ditës nuk është me vendimmarrje, pra nuk do të votohet. Është thjesht një relacion, një relacion informues, më saktë një relacion informues në lidhje me vijimin e procedurës së dhënies me qira të pasurisë 5 /89, zona kadastrale 15-34, me sipërfaqe 1584 metër katrorë, tregu i fruta-perimeve, ndërtesë dykatëshe, lagja Kastriot Fier, në pronësi të Bashkisë Fier. Ky është thjesht një relacion, nuk votohet dhe do... pra vetëm për të informuar bashkinë se mbaron kontrata e qirasë, mbaron tani në prill, fund prilli, dhe do vijojë më pas se si do të zgjidhet,

Z.Niko Neço

Mund të bëj një ndërhyrje?

Znj.Antoneta Çunaj

Informacion është ky, nuk miratohet.

Z.Niko Neço

Bëhet fjalë për tregun tek lagjia Kastriot, me pronësi të Bashkisë Fier. Në 2006 është lidhur një kontratë e cila në prill 2026 mbaron afati 20 vjeçar dhe u gjykua e arsyeshme që të informojmë këshillin, se në bazë të ligjit të pushtetit vendor këshilli shqyrton alternativën e vijimësisë së marrjes me qira apo të vijimësisë së administrimit të atij aseti, duke pasur si fokus pjesën e tregtarëve që ushtrojnë aktivitetin aty që kanë dhe një impakt natyrisht në qytet sa i takon aktivitetit ambulant dhe ushqimor. Kjo është pak a shumë thjesht një informacion i shkurtër.

Znj.Antoneta Çunaj

Tani vazhdojmë sepse thashë që kjo është pa vendimmarrje, është thjeshtë informacion.

Pika e nëntë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për miratimin e kërkesës së shoqërisë 'Poëer Energy' sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit 'Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore të transmetimit të energjisë elektrike' në pronat e Bashkisë Fier"

Znj.Antoneta Çunaj

Tani kush e do fjalën?

Znj.Erlinda Llupi

Komisioni është mbledhur ditën e djeshme dhe ka votuar dy kundër dhe tre pro për ta kaluar në këshill.

Znj.Antoneta Çunaj

Tani në lidhje me faktin që ka edhe kundër edhe pro, kush e do ndonjëri fjalën nga këta që janë kundër? Nuk ka e hdim në votim. Kush është pro?

Pro 28 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim 5 vota.

Miratohet

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Miratimin e Planit të masave për mbrojtjen kundër zjarrit' dhe Planit të Veprimit' për Bashkinë Fier, për vitin 2026.

Znj.Antoneta Çunaj

Materiali u ka ardhë. Fillimisht nga komisioni përkatës, nëse është mbledhur, e ka diskutuar. Ka? E do fjalën? Jo. Kryetarët e grupeve të forcave politike? Jo. Ndonjë sqarim, ndonjë interpretim nuk keni? Doni ndonjë sqarim, ndonjë qartësi nga përfaqësuesit apo nga nënkryetarët s'doni? Hidhet në votim. Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim s'ka.

Miratohet

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në 2026-2028. Bashkia Fier.

Znj.Antoneta Çunaj

Edhe ky plan ju ka ardhur. Në lidhje me këtë, përfaqësuesi i komisionit dëshiron të flasë? Kryetarët e grupeve? Jo. Ndonjë anëtar këshilli? Jo. Ndonjë pyetje, ndonjë diskutim nga bashkia, ndonjë paqartësi s'ka. Hidhet në votim. Ka nga këta? Doni ndonjë sqarim? S'ka nevojë. Jo. Kush është pro?

Pro 34 vota.

32

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim: Për miratimin e pagesës për mbulimin e shpenzimeve të transportit mortor për të ndjerin Detlef Ferig. në vlerën prej 20,000 lekish.

Znj.Antoneta Çunaj

Pika 12 e rendit të ditës është hequr, kemi pikën 13 të rendit të ditës

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për miratimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Qirjako Ferti në vlerën prej 84,000 lekësh.

Znj.Antoneta Çunaj

Ju materiali ju ka ardhur. Ka komision? Do ndonjëri fjalën?

Znj.Erlinda Llupi

Në mbledhjen e komisionit ka kaluar për miratim.

Znj.Antoneta Çunaj

Do ndonjëri fjalën? Jo. Kush është pro?

Pro 34 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet

Pika e katërbëdhjetë e rendit të ditës.



Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB Nr. 14, datt 29.01.2026. *Për ngritjen e komisionit për trajtimin e kërkesave për ndihmë të menjçhershme dhe për riparim banesash' pranë Bashkisë Fier."

Znj.Antoneta Çunaj

Të flasi përfaqësuesi i Grupit të Partisë Socialiste.

Z.Marjus Voja

Atëherë kërkojmë në këtë pikë që pika tre e vendimit të Këshillit Bashkiak të datës 14 janar 2026 të ndryshohet si vijon: "Komisioni të përbëhet nga shtatë anëtarë duke respektuar parimin e përfaqësimit të këshilltarëve, ekspertëve dhe shoqërisë civile, të ndarë si vijon: katër anëtarë të Këshillit Bashkiak Fier, tre anëtarë të administratës së bashkisë, përfaqësues të shërbimeve sociale, sektorit juridik dhe shërbimeve publike. Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve jo këshilltarë të bëhet mbi bazën e propozimeve të paraqitura nga subjektet e përcaktuara në pikën tre të nenit 43 të rregullores."

Znj.Antoneta Çunaj

Po, faleminderit. E do ndonjëri tjetër fjalën? Nuk e do njëri, sqarim tjetër nuk ka. Hidhet në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet

Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për dhënien e titullit Qytetar Nderi z. Miti Nushi dhe 2. Llazar Pove."

Znj.Antoneta Çunaj

Pika 15 e rendit të ditës është hequr, kemi pikat shtesë të rendit të ditës

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.



34



Projektvendim: Për miratimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale 2026-2028 të Bashkisë Fier

Znj.Antoneta Çunaj

Kemi Planin Social të Bashkisë Fier, i cili ju ka ardhë si material. Komisioni është mbledhur? Po.

Z.Elvi Daka

Atëherë, është mbledhur komisioni dhe në fakt ne si këshilltarë ndihemi mirë që më në fund Bashkia Fier arriti të realizojë me sukses planin e saj social, i cili ka në fushë veprimtarie të tij ndihmën dhe mbështetjen ndaj grupeve më vulnerabël, që përfshihen fëmijët, duke lidhur pak edhe me planin e barazisë gjinore, gratë viktime të dhunës në familje, gratë kryefamiljare, por gjithashtu të miturit në konflikt me ligjin. Dhe ky është një plan gjithëpërfshirës. Është bërë një konsultim publik me prezencën e të gjithë aktorëve, duke ftuar organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të institucioneve shkollore por edhe përfitues të këtyre shërbimeve të Bashkisë Fier. Mendoj që plani është i konsoliduar në të gjitha pikat e tij dhe ftoj të gjithë këshilltarët për mbështetje, sidomos një nismë nga gratë këshilltare, të cilat kanë vendosur përmes ndihmës që do t'u ofrohet nënave dhe grave kryefamiljare në pjesën e çerdheve dhe kopshteve, një propozim që është bërë nga përfaqësuese e grave këshilltare në konsultim publik. Kështu që faleminderit dhe ftoj të gjithë këshilltarët, kolegët që ta votojnë.

Znj.Antoneta Çunaj

Do ndonjëri tjetër fjalën përveç... ndonjë anëtar këshilli? E do fjalën? Nuk e doni? Hidhet në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

Projektvendim:“Mbi miratimin e vijimit të procedurave administrative-ligjore nga Komisioni i privatizimit , Bashkia Fier , për familjen e shtetasit Agim Balil Skëndaj , për të cilin është miratuar

nga Këshilli i Bashkisë Fier datë 11/12/2025, Relacioni Nr.13941 Prot, datë 16/11/2025 “ Mbi shqyrtimin e kërkesës për kryerjen e procedurës së privatizimit të shtetasit Agim Balil Skëndaj “ në mbledhjen e Këshillit të bashkisë Fier datë 11/12/2025 .

Znj.Antoneta Çunaj

Vijojnë procedurat e privatizimit të banesave në bazë të ligjit për privatizimin e banesave. Materiali ju ka ardhur. E kemi diskutuar edhe paraprakisht në kryesi në lidhje me këtë procedurë, është një procedurë që kanë mbetur përgjysmë për shkak se nuk është bërë me noter dhe tani duke qenë se ato janë paguar dhe dokumentacioni është i plotë i kalon kompetencë Bashkisë Fier. Doni sqarime të tjera? Këto do t'i kemi herë pas here sepse kjo do jetë në vazhdimësi se varet se sa apartamente kanë mbetur në bazë të ligjit të apartamenteve shtetërore. Kush është pro? Do ndonjëri fjalën? Asnjë. Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim 1 votë.

Miratohet

Znj.Antoneta Çunaj

Këto ishin projektvendimet që miratuam për sot. Faleminderit!

Ky procesverbal ka 36 (tridhjetë e gjashtë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.


Sekretar i Këshillit
Arnando Çupa

Kryetar i Këshillit
Antoneta Çunaj
